



# S T A T U T

## I

### SHOQERISE "PERLA" SHPK

Shoqeria "PERLA" SHPK, ka fituar PERSONALITET JURIDIK me vendimin Nr.15660, dt.19.08.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me Kontraten e Dhurimit Nr.2707/321,dt.16.07.1998,une IIJAZ HASANBELLI,kam pranuar dhurimin e 100% te kuotave te kesaj shoqerie dhe kjo kontrate dhurimi eshte depozituar ne Regjistrin Tregetar me Vendimin Nr.15660/1-5548,dt.22.07.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane...

Me pas me vendimin Nr.2,dt.27.07.1998 jane bere ndryshime ne Statut,te cilat jane depozituar ne Regjistrin Tregetar me Vendimin Nr.15660/2-5564, dt.28.07.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me Vendimin Nr.3, dt.02.04.1999 eshte ndryshuar objekti i veprimitarise se shoqerise, duke u pergendruar vetem ne fushen e turizmit, akte keto qe jane depozituar ne Regjistrin Tregetar me Vendimin Nr.15660/3-6408, dt.06.04.1999....

Me Vendimin Nr.4, dt.26.05.2000, eshte bere nje shtese ne objektin e veprimitarise se shoqerise, per ta shtrire aktivitetin e saj edhe ne fushen e Veprimitarise Televizive dhe jane bere po me kete vendim, eshte vendosur te ndryshohet Statuti, sipas pershkrimt te bere me poshte:

#### RRKU I

#### Dispozita te pergjitheshme

##### Neni 1

Ortak i Vvetem i shoqerise "PERLA" SHPK eshte Z.IIJAZ HASANBELLI, biri i Skenderit, dtl.1959, banues ne Durres, Lagja Nr.13, Iliria-Plazh-Durres...

##### Neni 2

Shoqeria "PERLA" SHPK eshte krijuar si person juridik shqiptar dhe vepron si e tille, qe nga dita e regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane, me Vendimin Nr.15660, dt.19.08.1996 dhe e paisjes me leje nga organet tatimore.

Veprimitaria e shoqerise rregullohet sipas ketij Statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

##### Neni 3

Selia e shoqerise "PERLA" SHPK eshte ne Republikën e Shqiperise ne qytetin e Durresit me adrese: Lagja Nr.13, Iliria-Plazh-Durres,(prane Hotel "FLORIDA"), me Tel. Nr.223-40, Nr.242-86...

Shoqeria mund te krijojë degë, perfagesi ose agjensi ne Republikën e Shqiperise ose jashte saj.



#### Neni 4

Shoqeria ka vullen e saj me forme te rrubullaket ose katrore mbishkrimin Shoqeria "PKRLA" SHPK - DURRES.

#### Neni 5

Veprimtaria e shoqerise do te vazhdoje per nje periudhe kohe kohe 10 (dhjete) vjecare, kohe e cila ka filluar ne daten e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane (dt.19.08.1996)..Ky afat mund te zgjatet me miratimine Ortakut te Vetem qe perfaqeson te gjithë kapitalin themeltar...

#### Neni 6

##### Objekti i veprimtarise

Shoqeria "PKRLA" SHPK ka si objekt te veprimtarise:

1. BAR-BUFFE RESTORANT-HOTELIERI-TURIZEM, organizim seminaresh, simpoziumesh dhe veprimtari te tjera te kesaj natyre...  
Sherbime qe lidhen me pritjet turistike, si organizim i vizitave ne qytete muze, monumente kulture, sherbim i guide perkthyesve, i shoqeruesve etj...
2. Veprimtari Televizive, konform kerkesave te Ligjit Nr.8410, dt.30.09.1998 "Per Radion dhe Televizioni Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise" si dhe ne perputhje me aktet e tjera ligjore e nenligjore qe plotesojne kete ligj....

#### KREU II

##### Kapitali themeltar dhe kuota

#### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise "PKRLA" SHPK perbehet vetem nga kontributi ne para dhe eshte ne shumën 100.000 (njëqintmije) Leke shqiptare.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 (njëqind) pjese, sejcila me vlere nominative 1.000 (njemije) leke.

Kuota ne % e ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte 100 %.

#### KREU III

##### Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar

#### Neni 8

Pjeset nominative te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rast ndarjeje pasurore midis bashkeshortëve, ne rruge trashegimie tek paraardhesit dhe pasardhesit si dhe tek te

tretet.

Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar behet me miratimin e ortakut te vetem te shoqerise.

#### KRRI IV

#### Administrimi dhe drejtimi i shoqerise

##### Neni 9

ADMINISTRATOR i Shoqerise "PERLA" SHPK, eshte ortakut i vetem Z. ILJAZ HASANBELLI, biri i Skenderit, lindur ne Durres, me daten 13.04.1959, banues ne Durres, l.Nr.13, Iliria-Plazh-Durres.....

Ne funksion te aktivitetit qe kryen shoqeria, ortakut i vetem mund te emeruje edhe administratore te tjere te cilet mund te jene persona vendas ose te huaj....

#### Kompetencat e administratoreve

##### Neni 10

Ortakut i vetem dhe njekohesisht ADMINISTRATORI i shoqerise, Z. ILJAZ HASANBELLI ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise.

Ai, perfaqson shoqerine para te treteve, ne gjykata, arbitrazhe, disponon pasurine dhe interesat e saj....

#### Marreveshjet e ndaluara

##### Neni 11

Administratorit te emruar nga ortakut i vetem nuk i lejohet te kontraktoje ne cfardolloj menyre qofte, te marre hua tek shoqeria, te jape pelqimin ne emer te saj per paradhenie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj (shoqerise) angazhi me ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Kjo mase zbatohet edhe ndaj perfaqsesve ligjore te ortakut te vetem, ndaj bashkeshorteve, paraardhesave dhe pasardhesave dhe ndaj cdo personi ndermjetes.

#### Pergjegjesite ligjore te administratoreve

##### Neni 12

\* Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve, per shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

\* Klauzolat e Statutit qe kufizojne kompetencat e administratoreve duhet te respektohen nga te tretet. Shoqeria nuk merr per siper pasojat ndaj te treteve, kur provon se te tretet e dinin se

akti i administratorit i kalon kompetencat e tij, apo objektin e veprimtarise se shoqerise.

\* Pasojat e marreveshjeve te pa miratuara, qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat perkatese.

\* Rregullat e ketij neni nuk zbatohen per marreveshjet qe behen per operacionet e perditeshme dhe te kryera ne kushte normale.

#### Neni 13

Ortaku i vetem ka te drejte qe, pervec padise civile per shperblimin e demit, te kerkoje edhe ndjekje penale kunder administratorëve.

#### Shkarkimi i administratorëve

#### Neni 14

Administratorët shkarkohen me vendim te ortakut te vetem ose nga gjykata.

#### KREU V

#### Asambleja e ortakeve

#### Neni 15

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor i shoqerise. Vendimet e saj protokollohen.

Ne shoqerine "PERLA" SHPK asambleja perbehet vetem nga Zoti ILJAZ HASANBKLLI, cili zoteron 100 % te votave.

#### Kompetencat e asamblese

#### Neni 16


Asambleja e ortakeve ka te drejte te kryeje ne cdo kohe verifikimet dhe kontrollet qe ajo i shikon te arsyeshme dhe kerkon te njihet ne cdo kohe me dokumentat qe ajo i gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se saj.

Asambleja e ortakeve emerion dhe shkarkon administratorët, keshillin administrativ, ekspertet kontabel te autorizuar dhe cakton kompetencat, sektoret qe do te mbulojne dhe angazhimet e tyre.

Asambleja merr vendime per transferimin e kapitalit, sipas procedures se percaktuar ne nenin 8(tete) te Statutit.

Merr vendime per zgjatjen e afatit te te veprimtarise se shoqerise, ose per zgjerimin e objektit te veprimtarise se saj, per zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit themeltar.

Merr vendime per ndryshimin e tipit te shoqerise ne vartesi te kapitalit themeltar te shoqerise.



Merr vendime per ndryshimin e Statutit ose plotesimin e tij ne rastet kur ajo (asambleja) e cmton te arsyeshme dhe ne varesi te ndryshimeve te legjislacionit shqiptar.

#### Ndryshimet e Statutit

##### Neni 17

Ndryshimet e Statutit dhe te Aktit te Themelimit vendosen nga asambleja e ortakeve.

#### Zmadhimi i kapitalit themeltar

##### Neni 18

Zmadhimi i kapitalit themeltar behet me vendim te asamblese se ortakeve, pasi ortaku i vetem ne menyre individuale ka deklaruar, ka nenshkruar dhe ka shlyer (derdhur) pjeset e kapitalit qe do te zmadhohet, ne formen e kontributeve ne natyre ose ne para.

Zmadhimi i kapitalit themeltar nuk perfaqson kontributet ne sherbime.

Ne cdo rast, zmadhimi i kapitalit themeltar shoqerohet me nje vendim asambleje per ndryshime ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut, ku percaktohet shprehimisht pjesemarrja e ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te zmadhuar si dhe kuota e re.

#### Zvoglimi i kapitalit themeltar

##### Neni 19

Zvoglimi i kapitalit themeltar behet me vendim te asamblese se ortakeve.

Zvoglimi i kapitalit themeltar e prek ortakun e vetem ne ate mase, sa jane pjeset e kapitalit qe ai perfaqson.

Kur asambleja merr vendim per zvoglimin te kapitalit themeltar (qe motivohet nga humbjet e rezultuara te shoqerise) nen limitin e parashikuar ne Kodin Tregtar te Shqiperise per sh.p.k.-te atehere ky vendim do te shoqerohet me keto veprime:

1. Ndryshimi i tipit te shoqerise;
2. Ndryshimi i Statutit;
3. Publikimi dhe njoftimi i te treteve me te cilet shoqeria ka mardhenie kontraktuale si dhe kreditorët.

Kur asambleja e ortakeve miraton nje projekt vendim per zvoglimin e kapitalit themeltar, qe nuk motivohet nga humbjet, kreditorët, kredia e te cileve eshte dhene para dates se publikimit te ndryshimeve perkatese ne Statut, mund te kundershtojne zvoglimin e kapitalit brenda 1 (nje) muaji nga kjo date ne rruge gjyqsore.



## Neni 20

### Eksperti kontabel i autorizuar

#### Karimi dhe Shkarkimi

Karimi i ekspertit kontabel te autorizuar behet me vendim te asamblese se ortakëve dhe eshte i detyrueshem kur ne mbyllje te vitit financiar tejkalohen dy nga tre treguesit e meposhtem:

1.Totali i bilancit	:	6.000.000 leke;
2.Totali i te ardhurave vjetore:		12.000.000 leke;
3.Numri mesatar i te punesuarve:		10 vete;

Shqyrtimet e bera pa caktuar ekspert kontabel te autorizuar ne rastet e detyruara me ligj si dhe raportet e eksperteve kontabel te autorizuar, te emruar ne kundershtim me rregullat e parashikuara nga Nenet 168 dhe 169 te Ligjit Nr.7638,dt.19.11.92 "Per shoqerite tregtare", jane te pavlefshme.

Ekspertet kontabel te autorizuar emrohen per nje periudhe 6 (gjashte) vitesh financiare, neqoftese asambleja e ortakëve nuk merr vendim per shkarkimin e tij para mbarimit te mandatit.

Ne rast gabimi ose pengimi, eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te asamblese se ortakëve si dhe me vendim gjykate.

#### Detyrat e ekspertit kontabel te autorizuar.

Garanton qe llogarite vjetore jane te rregullta dhe te hartuara me sinqeritet konforme ligjeve.

Pasqyron rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen financiare te trashegimise se shoqerise ne fund te ketij viti financiar.

Verifikon librat e llogarive dhe fondet e shoqerise dhe kontrollon pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi.

Verifikon perputhjen me llogarive vjetore te informacioneve te dhena nga administratoret perpara asamblese se ortakëve si dhe dokumentat mbi gjendjen financiare qe i jane paraqitur kesaj te fundit.

Eksperti kontabel i autorizuar eshte i detyruar ti beje te njohur administratoreve dhe asamblese se ortakëve:

a) Kontrolllet dhe verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet qe kane bere;

b) Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit qe duhen ndryshuar dhe sugjerojne metodat per perpilimin e ketyre dokumentave;

c) Parregullsite dhe pasaktesite qe kane zbuluar;

d) Perfundimet qe rrjedhin nga korrigjimi i pasaktesive te mesiperme, mbi rezultatet financiare te shoqerise.

Eksperti kontabel i autorizuar thirret ne te gjitha mbledhjet e asamblese se ortakëve kur shqyrtohet mbyllja e llogarive

te vitit financiar te perfunduar dhe sa here kerkohet nga asam-  
bleja.

### Pergjegjsite ligjore te ekspertit kontabel

Eksperti kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj shoqe-  
rise dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga  
fajet dhe nenvleftesimet ne ushtrimin e funksionit te tij, por  
nuk jane pergjegjes per shkeljet ligjore te kryera nga administra-  
toret, me perjashtim te rasteve kur kane pasur dijeni per to, por  
nuk i kane zbuluar dhe raportuar ato ne mbledhjet e asamblese.

#### Neni 21

##### Shnderrimi i shoqerise

Shnderrimi i shoqerise "PERLA" SHPK ne nje shoqeri kolektive  
apo komandite behet me vendim te ortakut te vetem...

Ky shnderrim eshte i detyrueshem per shoqerine kur kapitali  
themeltar bie nen limitin e domosdoshem per sh.p.k.-te, limit ky  
i percaktuar ne Kodin Tregtar Shqiptar.

#### Neni 22

Shnderrimi i shoqerise "PERLA" SHPK ne shoqeri anonime behet  
me vendim te ortakut te vetem, duke zbatuar rregullat mbi ndryshi-  
met e Statutit (Neni 17 i ketij Statutit) me kusht qe parapraki-  
sht te jete hartuar dhe aprovuar bilanci i dy viteve te fundit te  
aktivitetit te shoqerise.

Para marrjes se vendimit per shnderrimin ne shoqeri anonime,  
sipas rastit, ortaku i vetem, eshte te caktoje nje ekspert konta-  
bel te autorizuar, per pergatitjen e raportit mbi gjendjen e sho-  
qerise.

Cdo shnderrim ne kunderahitim me rregullat e ketij neni eshte  
i pavlefshem.

#### KRKU VI

##### Rezerva e domosdoshme, shperndarja e fitimit, dividendet

#### Neni 23

##### Rezerva e domosdoshme

Shoqeria "PERLA" SHPK, nga fitimi i realizuar gjate vitit  
financiar, pasi te zbriten humbjet e vitit te neparshem, eshte e  
detyruar te lere menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e fi-  
timit, e cila formon fondin rezerve, te quajtur "Rezerva e domos-  
doshme".

Dispozita e mesiperme nuk eshte me e detyrueshme kur "Reze-



nga "Rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

#### Neni 24

##### Shperndarja e fitimit

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, nga i cili eshte zbritur "Rezerva e domosdoshme" sipas Nenit 23 te Statutit dhe nga ana tjeter jane zbritur ose shtuar humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e meparshme.

Sipas rastit, ortaku i vetem ose asambleja e ortakëve, mund te vendosin shperndarjen e shumave te lena menjane per rezerven, me kusht qe te mos preket "Rezerva e domosdoshme" ne masen e parashikuar ne Nenin 23 te Statutit. Vendimi tregon shprehimisht llojin e rezerves ku jane marre keto shuma.

Pervec rasteve te zvoglimit te kapitalit themeltar, nuk mund te behet asnje shperndarje, neqoftese kapitalet, mbas kesaj shperndarje, do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus "Rezerven e domosdoshme", te percaktuar ne Statut.

#### Neni 25

##### Percaktimi i dividendeve

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te shumes qe do te shperndahet, asambleja percakton pjesen qe do te shperndahet si dividend (Ndarja e fitimit ne raport me kuoten qe zoteron ortaku i vetem).

Shoqeria ka te drejte te jape edhe paradhenie, vlera e te cilave ka rrjedhur nga vitet financiare te mbyllura ose ne vazhdim, vlera keto te derdhura para mbylljes se vitit financiar, me kusht qe:

- a) Te mos preket "Rezerva e domosdoshme";
- b) Shuma qe ka depozituar shoqeria si rezerve, te jete te pakten e barabarte me paradheniet e shperndara;
- c) Te perpilohet nje raport nga eksperti kontabei, i cili konfirmon se fitimet neto te realizuara deri ne ato kohe jane me te medha se paradheniet e shperndara.

Shperndarja e paradhenieve vendoset nga ortaku i vetem. Ne vendim percaktohet shuma dhe data e kthimit.

#### KREU VII

##### Pavlefshmerite dhe prishja e shoqerise

#### Neni 26

##### Rastet e pavlefshmerise

Pavlefshmeria e shoqerise "PKRLA" (Aktit te Themelimit ose



Statutit) si dhe pavlefshmeria e akteve te tjera te saj, (vendime-  
te asamblese, raporteve te ekspertit kontabel te autorizuar,  
detyrimeve te administratoreve etj) mund te rezultojne vetem nga  
shkelja e nje dispozite urdheruese apo ndaluese te Ligjit Nr.7638  
dt.19.11.1992 ose e legjislacionit ne fuqi per kontratat dhe  
veprimet juridike te parashikuara ne Kodin Civil.

Pavlefshmeria e shogerise "PERLA" SHPK mund te rezultoje  
edhe nga paftesia e ortakut te vetem.

#### Neni 27

#### Prishja e shogerise

Prishja e shogerise "PERLA" SHPK shpallet sipas rastit nga  
ortaku i vetem, vetem ne rastet e poshteshenuara:

1. Me perfundimin e afatit te parashikuar ne Kontraten e Theme-  
limit dhe ne Statut, neqoftese ortakut i vetem nuk merr vendim per  
zgjatjen e afatit te veprimtarise se shogerise.
2. Me humbjen e 1/2 se kapitalit themeltar, kur ky i fundit bie  
ne limitin e parashikuar per sh.p.k.-te ne Kodin Tregtar, rast  
per te cilin zbatohet kjo procedure:

Ne rast se kapitalet e shogerise, per shkak te humbjeve te  
konstatuara ne dokumentat financiare, rezultojne me te vogla se  
1/2 (gjysma) e kapitalit themeltar, ortakut i vetem brenda 4  
(kater) muajve nga konstatimi i kesaj gjendje, vendos per munde-  
sine e prishjes se shogerise.

Ne rast se nuk shpallet prishja, shogeria detyrohet te  
zvogloje kapitalin themeltar me nje vlere jo me te vogel se vlera  
e humbjeve te pambuluara nga rezervat, duke patur parasysh edhe  
limitin e parashikuar nga Kodi Tregtar per sh.p.k.-te.

Ky operacion duhet te kryhet brenda vitit financiar.

3. Me fillimin e procedures se falimentimit sipas kerkesave te  
Ligjit Nr.8017, dt.25.10.1995.

#### Neni 28

#### Likuidimi

Ne te gjitha rastet, kur me vendim gjykate shpallet pavlef-  
shmeria absolute apo relative e shogerise, si dhe ne rastet kur  
asambleja merr vendim per prishjen e saj (raste te parashikuara

ne Statut), fillon procesi i likuidimit te shoqerise, proces i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne Kodin Treg-  
DURRES Shqiptar.

**ORTAKU I VETEM**

**I**

**SHOQERISE "PERLA" SHPK**

*Iljaz Hasanbelli*  
*[Signature]*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTEREVE DURRES**  
**Nr.2920 Rep.Nr.163 Kol.**

**V E R T E T I M**

Ne Durres, sot me dt.28.05.2000, para meje, Noterit Publik ILIA KONA, u paraqit Z.ILJAZ HASANBELLI, me gjeneralitetet e lart permendura, identitetin e te cilit e vertetova me pasaporten Nr.0557333, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i cili me cilesine e te Ortakut te vetem te shoqerise "PERLA" SHPK, deklaroi se Statutin e mesiperme kupton dhe e pranon pasi pasqyron vullnetin e tij te lire dhe me pas e neneshkroi ate ne pranine time...

Per sa siper une noteri vertetoj....

**NOTERI**

/ ILIA KONA /



**K O N T R A T E**  
**PER**  
**THEMELIMIN E SHOQERISE "PERLA" SH.P.K.**

Sot, ne Durres me date 21.06.1996, une ortakun i vetem Arjan Laçi, i biri Nikolles, i datelindjes 1959, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, themeloi shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar " PERLA " Sh.p.k e cila ka si objekt te veprimtarise:

- Sherbimin e agjencise detare dhe spedicionere.
- Sherbime furnizim anije .
- Sherbim mbledhje plehrash.
- Sherbim pilotimi
- Sherbim ruajtje skafesh.
- Sherbim konsulence teknike per aktivitete detare.
- Aktivitete tregtare, import- eksport, me shumice e me pakice e aktivitete te tjera qe lejon ligji .

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj vetem, ose duke pranuar edhe ortakun te tjere.

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Durresit.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet. Ajo do ta ushtroje aktivitetin e saj per te gjithë kohën me perjashtim te rasteve te parashikuara ne statut .

Kapitali i shoqerise per fillimin e punes do te jete 100 000 leke. Ortaku i vetem ka te drejte ta shtoje ose ta paksoje ate sipas kushteve te realizimit te fitimit.

Shoqeria ka si administrator te saj ortakun e vetem zotin Arjan Laçi, i cili ka te drejte qe te administroje shoqerine vete ose duke caktuar persona te tjere me prokure, autorizim apo me kontrate pune.

Shoqeria eshte themeluar ne mbeshtetje te ligjit per " Shoqerite Tregtare " dhe do te zbatoje per kryerjen e aktivitetit te saj legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Ky akt themelimi u formulua ne pese kopje dhe pasi u lexua u firmos rregullisht nga ortakun i vetem.

**T H E M E L U E S I**  
**O R T A K U I V E T E M**  
**A R J A N L A Ç I**



**STATUT**  
**I**  
**“ PERLA “ .SH.P.K.**

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 “Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarur e te privatizimit” si dhe te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, une Arjan Laçi, i biri i Nikolles , lindur ne Durres me 1959, banues ne Durres, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, shpall:

**NENI 1**  
**THEMELIMI**

Themelimin e Shoqerise tregtare “ PERLA “ SH.P.K.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia e “ PERLA “ Shpk do te jete ne , qytetin e Durresit. Ajo mund te cele edhe seli te tjera ne territorin e Shqiperise ose jashte tij.

**NENI 3**  
**KOHEZGJATJA**

“ PERLA “SH.P.K. do te ushtroje veprimtarine e saj per nje kohe mbi 10 vjet, me te drejte ripertesitje.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se saj to te jete ne fushen e agjencise detare dhe ekspedicionere dhe aktivitete te tjera te transportit detar e ne porte, veprimtari ne fushen e turizmit brenda dhe jashte vendit, si dhe veprimtari te tjera ne baze te marreveshjeve te ndersjellta tregtare, turistike,veprimtari tregtare ,eksport importi me shumice e pakice etj.

**NENI 5**

“ PERLA “ SH.P.K. mund te ndryshoje emertimin, seline ose objektin e veprimtarise se saj, me vendim te ortakut te vetem.

**NENI 6**  
**KAPITALI**

Kapitali themeltar i “ PERLA “ .Sh.p.k eshte 100.000 (njqindmije) leke, i formuar ne mase te plote nga ortaku i vetem , teresisht i shlyer dhe i nenshkruar prej tij.

*Arjan Laçi: Durres*





## NENI 7 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

“ PERLA “SH.P.K., vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime. Ajo pergjigjet vete per detyrimet brenda kapitalit te saj. Arjan Laçi eshte administrator i saj.

## NENI 8

“ PERLA “ SH.P.K. mund te çele llogari te saj ne leke ose ne valute ne bankat shqiptare apo te huaja. Ajo mund te marre kredi nga bankat shqiptare apo te huaja, private e shtetore, brenda e jashte vendit.

## NENI 9

“ PERLA “SH.P.K. eshte prone e ortakut te vetem .

## NENI 10

Ortaku mund te emeroje administrator, me akt emerimi, ku percakton pagen dhe detyrat.

## NENI 11

Perfaqesimi i “ PERLA “ SH.P.K., i perket ortakut te vetem, ose te deleguarit te saj ne baze te prokures se veçante, kur ka te tille. Ata perfaqesojne shoqerine ne organe dhe gjykime te ndryshme, caktojne dhe pushojne avokat per ceshtjet ne gjykim, etj.

## NENI 12

Ortaku i vetem ka edhe keto detyra:

- Administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me statutin
- Marrjen e informacionit per kete veprimtari
- Realizimin dhe perfitimin nga arritjet ne cdo forme e sasi.

## NENI 13 MARREDHENJET E PUNES

Ortaku i vetem mund te punesoje ne kete shoqeri persona fizike dhe shtetas shqiptare apo te huaj, sipas specialiteteve. Afati i ketij punesimi mund te jete ditor, javor, sezonal apo vjetor.

Arjan Laçi



**NENI 14**

Per sigurimin normal te aktivitetit lidhen kontrata pune me personat fizike me shoqeri te tjera tregetare, private apo shtetere, vendase apo te huaja.

**NENI 15**

Marredhenjet e punes rregullohen sipas legjislacionit ne fuqi.

Mosmarreshjet midis paleve zgjidhen ne rruge gjyqesore ne Tirane, por edhe me mirekuptim.

**NENI 16**

**BILANCI DHE TE ARDHURAT**

Veprimet ekonomike e financiare fillojne me 1 janar te cdo viti.

Veprimet ekonomike e financiare mbylleen ne daten 31 dhjetor te cdo viti, pervec urdherave te vecanta te ortakut te vetem ne fund te periudhes ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik fitim-humbje bazuar ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit.

Bilanci miratohet nga ortakut i vetem i shoqerise. Ato depozitohen ne Zyren e tatimeve sipas afateve ligjore.

**NENI 17**

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te akumulimit, te pages se punonjesve, te sigurimeve e te detyrimeve fiskale, etj., i mbeten per perdorim, pronarit te saj, ortakut te vetem. Eshte e drejte e tij te vendose per krijimin e fondeve prej te ardhurave neto apo per perdorimin e tyre.

**NENI 18**

Ortakut i vetem pakeson ose pushon veprimtarine e shoqerise kur bilanci i saj rezulton me humbje, duke vene ne dijeni te punesuarit per te, te pakten dy jave perpara.

**NENI 19**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cdo shkak qe vendos ortakut i vetem.

Pronari i saj vendos per menyren e likuidimit dhe cakton per kete nje ose me shume likuidatore, te cileve ju ve detyra konkrete.

**NENI 20**

Likuidatoret jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise derisa ajo tu dorezohet personave perkates fizike apo juridike, duke likuiduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete ndaj shoqerise.

*Arzjan Kocaj*

**NENI 21**

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet cdo ligji ne pergjithesi dhe atij tregetar ne vecanti.

**NENI 22**

Statuti nenshkruhet nga pronari i shoqerise " PERLA " SH.P.K., Arjan Laçi.

**ORTAKU**

**ARJAN LAÇI**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**NOTERIA TIRANE**

Nr, 8296 Rep,

1301

**VERTETIM**

Sot me date 13.06. 1996 ( nentedhjete e gjashte ), ne zyren e noterise ne Tirane, para meje noteres, u praqit personalisht z. Arjan Laçi me nenshtetesi shqiptare lindur me 1959 me banim ne Durres , me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi personal, i cili deklaroj se statuti eshte perpiluar me vullnetin e tij te lire dhe u nenshkruan para meje.

Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTER**

NOTERE PUBLIKE  
FATMARA SHEHU  
TEL 249 28



*Arjan Laçi*

